

UDHËZIM
Nr.8, datë 28.7.2004

**PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE PËR TË LUFTUAR FINANCIMIN
E TERRORIZMIT NË SISTEMIN E TATIM-TAKSAVE**

Neni 1

Dispozita të përgjithshme

1. Ky udhëzim është hartuar në mbështetje të neneve 5, 6, 7, 8, 10/1 dhe 12 të ligjit nr. 8610, datë 17.5.2000 "Për parandalimin e pastrimit të parave", i ndryshuar me ligjin nr.9084, datë 6.19.2003.
2. Ky udhëzim do të japë parimet e përgjithshme për shkëmbimin e informacionit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe Luftës kundër Financimit të Terrorizmit (autoriteti përgjegjës).

Neni 2

Përkufizime

Për qëllime të këtij udhëzimi, termat e mëposhtme do të kenë këto kuptime:

1. Pastrim parash–Qarkullimi dhe riciklimi i parave që burojnë nga vepra penale, sikurse dhe ndryshimi, transmetimi, transformimi dhe tjetërsimi i produkteve dhe pasurive të siguruara nga veprat penale që synon fshehjen e burimit ose të origjinës së paligjshme, (sipas paraqitjes në nenin 2 të ligjit).
2. Financimi i terrorizmit–Financimi i akteve terroriste dhe/ose i organizatave terroriste.
3. Transaksione të dyshimta–Çdo transaksion (pavarësisht sasisë), që nga natyra ose karakteri është i pazakonshëm për aktivitetin e personit, ose që për ndonjë arsye tjetër ngre dyshime për pastrim parash ose financim të terrorizmit.
4. Tatimpagues–"Klienti" i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve është një person fizik (biznes ose jo), person juridik ose përfaqësues ligjor, rezident ose jo në Shqipëri, i huaj ose shqiptar, privat ose publik, të cilit i kërkohet të paguajë tatime, të mbajë informacion ose të japë informacion për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.
5. Autoriteti përgjegjës–Drejtori i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit të Parave në Ministrinë e Financave. Brenda (autoritetit përgjegjës) ndodhet Njësia e Inteligjencës Financiare (NIF) që është një agjenci kombëtare qendrore përgjegjëse për të kërkuar, marrë, analizuar dhe shpërndarë dokumentet dhe informacionin, sipas ligjit, në mënyrë që të luftojë pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit.
6. Para–Për qëllime të këtij udhëzimi, "para" përfshin çdo lloj valute në qarkullim duke përfshirë kartëmonedha dhe monedha vendase dhe/ose të huaja.
7. Vepër penale–Sipas këtij udhëzimi, do të thotë veprim ose mosveprim, shoqërisht i rrezikshëm, i kryer me faj dhe i parashikuar nga ligji penal shqiptar ose i një vendi të huaj.
8. Të ardhura të paligjshme–Fonde monetare, pasuri të tjera ose të drejta të tjera pasurish, të zotëruara nga një person që janë fituar përmes kryerjes së një ose disa veprave penale.

Neni 3

Identifikimi i "tatimpaguesve"

1. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të mbajë informacionin e mëposhtëm lidhur me tatimpaguesit:
 - a) Persona fizikë jofitimprurës (individë)–Informacionin më të freskët lidhur me emrin e tatimpaguesit, mbiemrin, datëlindjen, vendlindjen, adresën e përkohshme dhe të përhershme të banimit, llojin dhe numrin e dokumentit zyrtar të identifikimit dhe institucionin që e ka lëshuar.
 - b) Personat fizikë fitimprurës–Informacionin më të freskët lidhur me emrin e tatimpaguesit, mbiemrin, numrin dhe datën e vendimit të gjykatës që lejon personin të kryejë aktivitet fitimprurës, numrin e identifikimit të tatimpaguesit, datën e lëshimit të lejes nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për ushtrimin e aktivitetit fitimprurës të personit.

c) Person juridik–Informacioni më i freskët lidhur me emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, datën e vendimit të gjykatës lidhur me regjistrimin si person juridik, numrin e identifikimit të taksave, datën e autorizimit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për të ushtruar aktivitetin fitimprurës, adresën e përkohshme dhe të përhershme të zyrës qendrore, natyrën dhe llojin e aktivitetit.

d) Përfaqësuesi ligjor–Informacioni më i freskët lidhur me emrin dhe mbiemrin e tatimpaguesit, datën dhe vendin e lindjes, numrin e dokumentit zyrtar të identifikimit të përfaqësuesit ligjor të klientit (ëve) dhe institucionin që e ka lëshuar atë, vërtetim për autorizimin e dhënë përfaqësuesit që të veprojë në emër të klientit.

Neni 4

Raportimi i aktivitetit të dyshimtë

1. Punonjësi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve duhet të ekzaminojë aktivitetet e mëposhtme dhe të përpiqet të zbulojë transaksione të dyshimta të pastrimit të parave dhe/ose të financimit të terrorizmit në çdo aktivitet dhe kryesisht në:

- a) negociatat për borxhet, kreditë ose garancitë e dhëna nga borxhmarrësi;
- b) transaksionet e lidhura me llogaritë bankare;
- c) transaksionet që lidhen me pagesat, transferimet e borxhit dhe çeqet;
- d) pagesat e ligjshme valutore;
- e) blerjen, shitjen, transfertën etj. e stokut, të bondeve, pasurive dhe borxheve;
- f) administrimin e fondeve të investimit;
- g) aktivitetet e kompanive të sigurimeve, duke përfshirë risigurimet;
- h) fatura të përgatitura nga blerësit;
- i) kuponat dhe certifikatat e taksave.

2. Nëse zbulohet një transaksion i dyshimtë lidhur me aktivitetet e mësipërme, atëherë duhet dërguar një raport tek autoriteti përgjegjës për “transaksionin e dyshimtë” (sipas shtojcave në anekset II dhe III për formularin dhe instruksionet bashkëlidhur, të cilat janë pjesë e këtij udhëzimi).

3. Raporti për transaksionin e dyshimtë duhet t’i dorëzohet autoritetit përgjegjës menjëherë, por jo më vonë se 72 orë pas zbulimit.

4. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas kërkesave të ligjit, ndalohen që të njoftojnë personat e përfshirë në një transaksion të dyshimtë për faktin se është dërguar një raport për transaksion të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës, apo që ky i fundit ka kërkuar informacion rreth veprimtarisë së tyre.

5. Raportimi i punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve bëhet sipas formularit bashkëlidhur, në ankesin II, shtojca ”Raporti i aktivitetit të dyshimtë”, që është pjesë e këtij udhëzimi.

Neni 5

Njësia qendrore

1. Me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të informacionit sipas këtij ligji, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të ngrejë një njësi qendrore që do të jetë përgjegjëse për identifikimin dhe mbledhjen e transaksioneve të dyshimta.

2. Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve do të caktojë një person me pozitë drejtuese për të drejtuar këtë njësi.

3. Kreu i njësisë:

a) do të caktojë një person në zyrën qendrore dhe në çdo degë, që të shërbejë si person kontakti për autoritetin përgjegjës;

b) do të organizojë procesin e monitorimit dhe do të sigurojë kryerjen e detyrave të përcaktuara nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit;

c) do të analizojë çdo transaksion që është identifikuar si i dyshimtë dhe do të përcaktojë nëse ai/ajo beson se është i dyshimtë sipas ligjit dhe këtij udhëzimi;

d) nëse informacioni është përcaktuar si i dyshimtë, kreu i njësisë do t’ia nisë informacionin autoritetit përgjegjës pas autorizimit të dhënë nga Drejtori ose zëvendës drejtori i Përgjithshëm i

Tatimeve;

e) do të konsultohet me punonjës të tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për rrugët për identifikimin e transaksioneve të dyshimta;

f) do të organizojë trajnim special për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve që të sigurojë se punonjësit:

i) janë të vetëdijshëm për ligjet dhe politikat që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

ii) kanë shprehitë e nevojshme për të kontrolluar transaksionet për të zbuluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

iii) janë të vetëdijshëm për kërkesat për raportim dhe sesi përgatitet një raport;

g) do të përgatisë raport me shkrim të paktën një herë në vit për procesin e monitorimit (duke përfshirë numrin e raporteve të dyshimta të identifikuara) dhe do t'ia dorëzojnë atë drejtorit të taksave;

h) do të monitorojë tatimpaguesit dhe transaksionet e referuara tek autoriteti përgjegjës dhe do t'ia komunikojë këtë dy herë në vit, përmes drejtorit të tatimeve, autoritetit përgjegjës.

4. Drejtuesit dhe punonjësve të njësisë qendrore duhet t'u jepet autoritet për të marrë çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur funksionet e tyre. Atyre do t'u kërkohet që të mbajnë konfidenciale natyrën e aktiviteteve të tyre.

5. Drejtuesi i njësisë qendrore do të raportojë vetëm te Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

6. Në rastet kur drejtuesi i njësisë qendrore mendon se ndonjë nga punonjësit nuk po merr pjesë në procesin e monitorimit, ai duhet të njoftojë menjëherë Drejtorin ose zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve.

Neni 6

Shkëmbimi i informacionit

Kur informacioni shihet i izoluar, mund të jetë i pakuptimtë, por kur kombinohet me të dhëna të tjera që gjenden në një bazë të vetme të dhënash, mund të çojë në identifikimin e pastruesve të parave apo të financuesve të terrorizmit. Kështu që, për të krijuar një bazë elektronike të dhënash me informacion historik, autoriteti përgjegjës, përmes personave të kontaktit, do të dërgojë kërkesë për informacion te Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Personat e kontaktit do të bien dakord për kohën e përgjigjes sipas afateve të parashikuara në ligj. Nëse ka ndonjë mosmarrëveshje lidhur me afatin e përgjigjes, atëherë çështja zgjidhet nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve dhe Ministri i Financave.

Neni 7

Raportimi i aktivitetit të dyshimtë

1. Kur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, përmes investigimit administrativ, civil apo penal, beson se është duke u kryer ose po kryhet krimi i pastrimit parave ose financim terrorizmi, ai njofton me shkrim menjëherë dhe jo më vonë se 72 orë autoritetin përgjegjës.

2. Pas marrjes së letrës nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve lidhur me persona, njësi ligjore apo përfaqësues ligjorë ose transaksione të përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, autoriteti përgjegjës do të kryejë menjëherë një kontroll të regjistrave zyrtarë dhe do t'i përgjigjet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 15 ditë. Sidoqoftë, kur është nevojë urgjente për informacion, kërkesa e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve mund të bëhet verbalisht dhe të konfirmohet me anë të një letrë brenda tri ditëve pune dhe drejtori i autoritetit përgjegjës ose përfaqësuesi i tij do të përgjigjet sa më shpejt të jetë e mundur.

3. Kërkesat e bëra nga autoriteti përgjegjës Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, lidhur me individë, biznese, persona juridikë, përfaqësues ligjorë dhe transaksione, do të bëhen me anë të një letrë që përmban informacion të mjaftueshëm për t'i dhënë mundësi Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që të bëjë kontrollin në regjistrat zyrtarë.

4. Sidoqoftë, kur ka arsye të bazuar për pastrim parash ose financim terrorizmi, dhe besohet se ka nevojë urgjente për informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, personi i kontaktit të autoritetit përgjegjës i bën një kërkesë verbale personit të kontaktit në Drejtorinë e Përgjithshme të

Tatimeve. Kërkesa të tilla duhet të dokumentohen brenda tri ditëve me anë të një letre me shkrim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

5. Informacioni i kërkuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do t'i jepet autoritetit përgjegjës jo më vonë se 15 ditë nga marrja e kërkesës; ky afat mund të ndryshojë vetëm kur për arsye të forta palët bien dakord me shkrim ta shtyjë ose ta afrojnë afatin. Çdo zgjatje nuk mund të jetë më tepër se 8 ditë.

6. Kur autoriteti përgjegjës ka bllokuar ose përgatitet të bllokojë një transaksion për 72 orë dhe kërkon informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, ky informacion duhet t'i vihet në dispozicion brenda 48 orësh. Kjo kërkesë mund të bëhet me shkrim ose me gojë. Çdo kërkesë me gojë do të dokumentohet me shkrim brenda tri ditësh pune.

7. Kur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka arsye të mjaftueshme të besojë se ka ndodhur pastrim parash ose financim terrorizmi që përfshin një vend të huaj, ai mund t'i kërkojë autoritetit përgjegjës që të bëjë kërkesë për informacion vendit të huaj. Kërkesa duhet bërë me shkrim ose në rastet urgjente me telefon (në rast se juridiksioni i huaj pranon). Kërkesa të tilla, duhet të kenë informacion të mjaftueshëm dhe detaje të tjera lidhur me persona, përfaqësues ligjorë ose transaksione që do të lejonin kontrollin e regjistrave në një juridiksion të huaj. Nëse kërkesa është bërë telefonikisht, ajo do të dokumentohet brenda tri ditësh pune.

8. Përdorimi i informacionit të marrë nga juridiksione të huaja do të kontrollohet nga të gjitha kufizimet e vendosura nga furnizuesi i informacionit.

9. Kur NIF, në një juridiksion të huaj, kërkon informacion i cili sipas autoritetit përgjegjës përfshin informacion nga tatimet, autoriteti përgjegjës do t'ia kërkojë këtë informacion Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkrim ose në rast urgjence me telefon. Kur kërkesa bëhet me telefon, ajo do të dokumentohet me shkrim brenda tri ditësh pune.

10. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të përgjigjet sipas parashikimeve në paragrafin 5 të këtij neni.

11. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të japë të gjithë informacionin që disponon, të cilin është e lejuar ta ndajë me juridiksione të huaja. Nëse ligji shqiptar e kufizon komunikimin e një pjese të informacionit (neni 15 i ligjit), atëherë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të identifikojë qartësisht këtë informacion në përgjigjen e vet (me shkrim ose me telefon) tek autoriteti përgjegjës.

Neni 8

Përgjegjësitë e punonjësit

1. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve do të ruajnë konfidencialitetin e të gjitha dokumenteve, të dhënave dhe të informacionit të marrë nga autoriteti përgjegjës; çdo nxjerrje e paautorizuar e këtij informacioni e bën punonjësin subjekt të përgjegjësisë penale dhe administrative.

2. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve që i japin informacion konfidencial autoritetit përgjegjës sipas kërkesave të ligjit janë të përjashtuar nga përgjegjësia penale ose administrative.

3. Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, për raste të shkeljeve dhe mos zbatimit të ligjit dhe të këtij udhëzimi, kur ato nuk përbëjnë veprë penale, kanë përgjegjësi administrative dhe ndëshkohen me gjobë nga autoriteti përgjegjës sipas parashikimeve në nenin 14 të ligjit.

Neni 9

Detyrimi për të mbajtur informacionin dhe dokumentet për transaksionet e dyshimta

1. Dokumentet ose informacioni që lidhet me transaksionet e dyshimta duhet të mbahet për të paktën pesë vjet nga data e zbulimit të transaksionit.

2. Dokumentet duhet të mbahen në origjinal dhe të ruhen në mënyrë të tillë që të dhënat të reflektojnë tërësisht transaksionin e kryer dhe palët e përfshira në të. Nëse ka vend, dokumentet duhet të mbahen në formë të tillë që të mund të përdoren si evidencë gjatë procedurave gjyqësore (për shembull të firmosura, të vulosura të noterizuara dhe të certifikuara).

3. Ruajtësi i dokumentit duhet të identifikohet dhe dokumenti duhet të tregojë qartë personin dhe datën e certifikimit. Dokumentet duhet të sistemohen, të ruhen dhe të mbahen në mënyrë të tillë që

mund të gjenden dhe të nxirren shpejt në rastet kur ato nevojiten.

4. Kur është mundësia, informacioni do të sistemohet dhe mbahet edhe në formë elektronike.

Neni 10

Data e hyrjes në fuqi

Kjo udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj

RELACION SHOQËRUES

PËR UDHËZIMIN “PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE LUFTËN KUNDËR FINANCIMIT TË TERRORIZMIT, NË SISTEMIN E TATIM-TAKSAVE”

Në zbatim të ligjit nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar me ligjin nr.9084, datë 19.6.2003, neneve 5, 6, 7, 8, 10/1 dhe 12, është përgatitur udhëzimi për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit në sistemin e tatim-taksave në Republikën e Shqipërisë.

Ky udhëzim ka për qëllim të përcaktojë mënyrën e zbatimit të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit, si dhe të qartësojë procedurat e raportimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave (e cila shërben si qendër kombëtare për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e zbulimit të informacionit financiar autoriteteve të zbatimit të ligjit, lidhur me pastrim parash dhe financim potencial të terrorizmit).

Përmirësimet në ligjin për parandalimin e pastrimit të parave të bëra me ligjin nr.9084, datë 19.6.2003, në nenin 10/1 specifikojnë detyrimet e organeve tatimore në raport me DPPPP-në (autoritetin përgjegjës), si dhe kërkojnë që format dhe procedurat e identifikimit dhe të raportimit të përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.

Në dallim me kërkesat e ligjit, të mëparshëm, organet tatimore shpëputen si subjekte të ligjit dhe marrin detyrime më vete lidhur me identifikimin e personave fizikë e juridikë të tyre, sipas procedurave të parashikuara në pikën 2 të nenit 4 të ligjit dhe i raportojnë autoritetit përgjegjës menjëherë dhe në çdo rast, jo më vonë se 72 orë pas regjistrimit të veprimit, për çdo dyshim, sinjalizim, njoftim ose të dhënë, që ka të bëjë me pastrimin e parave ose financim të terrorizmit.

Ndryshe nga subjektet e tjera të ligjit, organet tatimore do të raportojnë për çdo dyshim që konstatojnë gjatë veprimtarisë së tyre me personat fizikë ose juridikë, dhe jo për transaksionet mbi vlerat e përcaktuara në ligj. Ato do të raportojnë për çdo dyshim sipas formës së “Raportit të aktivitetit të dyshimtë” (RAD) në ankesin II të udhëzimit, i përcaktuar nga Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave bashkëlidhur dhe pjesë e udhëzimit.

Organet tatimore janë të ngarkuar nga ligji me detyrën për ngritjen e një njësie në qendër dhe caktimin e personave të kontaktit në degë dhe agjenci, të cilët do të sigurojnë një shkëmbim të shpejtë të informacionit lidhur me parandalimin e pastrimit të parave dhe për të luftuar financimin e terrorizmit.

Udhëzimi jep parimet e përgjithshme për shkëmbimin e informacionit midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit (autoriteti përgjegjës).

Udhëzimi përkufizon termet kryesore, si: “transaksione të dyshimta”, tatimpagues që për efekt të ligjit konsiderohen si “klient”, “autoritet përgjegjës”, “vepër penale”, “të ardhura të paligjshme” etj.

Ai paraqet detyrimet e organeve tatimore për identifikimin e tatimpaguesve, mbledhjen, ruajtjen dhe dërgimin tek autoriteti përgjegjës të informacionit mënyrën e raportimit të aktiviteteve të dyshimta.

Detyrimi për identifikimin e tatimpaguesve është kërkesë dhe e legjislacionit tatimor në Republikën e Shqipërisë, por në këtë udhëzim janë të përmbledhura ato kërkesa që nevojiten për efekt

të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave lidhur me personat fizikë fitimprurës ose jofitimprurës, personat juridikë, përfaqësuesit ligjorë të klientëve (tatimpaguesve).

Udhëzimi kërkon freskimin e informacionit lidhur me emrin e tatimpaguesit, mbiemrin, numrin dhe datën e vendimit të gjykatës që lejon personin të kryejë aktivitetin ligjor, numrin e identifikimit të tatimpaguesit, datën e lëshimit të lejes.

Në udhëzim, veç specifikimeve të formës së raportimit, specifikohet gjithashtu dhe mënyra, koha e raportimit, ngritja e njësisë qendrore dhe përcaktimi i personave të kontaktit në njësi e degë të organeve tatimore në nivele vendore.

Përcaktohet gjithashtu që punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve sipas kërkesave të ligjit ndalohen që të njoftojnë personat e përfshirë në një transaksion të dyshimtë ose t'i njoftojnë se është dërguar një raport për transaksion të dyshimtë tek autoriteti përgjegjës, apo që ky i fundit ka kërkuar informacion rreth veprimtarisë së tyre.

Ngritja e njësisë qendrore bëhet me qëllim lehtësimin e shkëmbimit të informacionit sipas ligjit, për identifikimin, mbledhjen, ruajtjen dhe raportimin e transaksioneve të dyshimta.

Në qendër caktohet një person me funksion dhe pozitë drejtuese për të drejtuar këtë njësi dhe rregulluar marrëdhëniet me autoritetin përgjegjës, si dhe një ndihmës dhe zëvendës të tij.

Kreu i njësisë cakton një person në zyrat qendrore, dhe në çdo degë, që të shërbejë si person kontakti për autoritetin përgjegjës. Ai do të organizojë procesin e monitorimit dhe do të sigurojë kryerjen e detyrave të përcaktuara nga ligji për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftës kundër financimit të terrorizmit. Analizon çdo transaksion që është identifikuar si i dyshimtë dhe përcakton nëse ai/ajo beson se është i dyshimtë sipas ligjit dhe sipas këtij udhëzimi. Nëse informacioni është përcaktuar si i dyshimtë, kreu i njësisë ia dërgon informacionin autoritetit përgjegjës pas autorizimit të dhënë nga Drejtori ose zëvendësdrejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Ai do të konsultohet me punonjës të tjerë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për rrugët lidhur me identifikimin e transaksioneve të dyshimta.

Ai do të organizojë trajnim special për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve që të sigurojë se punonjësit:

i) janë të vetëdijshëm për ligjet dhe politikat që lidhen me pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

ii) kanë shprehitë e nevojshme për të kontrolluar transaksionet për të zbuluar pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit;

iii) janë të vetëdijshëm për kërkesat për raportim dhe sesi përgatitet një raport.

Kreu i njësisë qendrore përgatit raporte me shkrim të paktën njëherë në vit për procesin e monitorimit (duke përfshirë numrin e raporteve të dyshimta të identifikuara) dhe t'ia dorëzojnë atë drejtorit të taksave.

Do të monitorojë tatimpaguesit dhe transaksionet e referuara tek autoriteti përgjegjës dhe t'ia komunikojë këtë dy herë në vit, përmes drejtorit të taksave, autoritetit përgjegjës.

Drejtuesit dhe punonjësve të njësisë qendrore duhet t'u jepet autoritet për të marrë çdo informacion të nevojshëm për të përmbushur funksionet e tyre. Atyre u kërkohet që të mbajnë konfidenciale natyrën e aktiviteteve të tyre.

Drejtuesi i njësisë qendrore do të raportojë vetëm te Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve.

Në rastet kur drejtuesi i njësisë qendrore mendon se ndonjë nga punonjësit nuk po merr pjesë në procesin e monitorimit ai duhet të njoftojë menjëherë Drejtorin ose zëvendësdrejtorin e Përgjithshëm të Tatimeve.

Udhëzimi përcakton dhe procedurat e shkëmbimit të informacionit, mënyrën dhe afatet e raportimit të aktiviteteve të dyshimta që lidhen me pastrim parash apo implikime në financim terrorizmi, si dhe rastet kur Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve kërkon informacion te Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, ose informacione që lidhen me shërbime homologe ose kanë nevojë për plotësim me informacion nga këto shërbime. Informacioni i marrë nga juridiksione të huaja do të kontrollohet nga të gjitha kufizimet e vendosura nga dhënësi i informacionit.

Sidoqoftë, kur ka arsye të bazuar për pastrim parash ose financim terrorizmi dhe besohet se ka nevojë urgjente për informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, personi i kontaktit të autoritetit përgjegjës i bën një kërkesë verbale personit të kontaktit në Drejtorinë e Përgjithshme të

Tatimeve. Kërkesa të tilla duhet të dokumentohen brenda tri ditëve me anë të një letre me shkrim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve të japë të gjithë informacionin që disponon, të cilin është e lejuar me ligj ta ndajë me juridiksione të huaja. Nëse ligji shqiptar e kufizon komunikimin e një pjese të informacionit (neni 15 i ligjit), atëherë Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve do të identifikojë qartësisht këtë informacion në përgjigjen e vet (me shkrim ose me telefon) tek autoriteti përgjegjës.

Punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve do të ruajnë konfidencialitetin e të gjithë dokumenteve, të dhënave dhe të informacionit të marrë nga autoriteti përgjegjës; çdo nxjerrje e paautorizuar e këtij informacioni e bën punonjës in subjekt të përgjegjësisë penale dhe administrative.

Moszbatimi i kërkesave të ligjit për parandalimin e pastrimit të parave në rastet kur nuk përbën vepër penale përbën shkelje administrative dhe dënohet me gjobë sipas përcaktimeve në nenin 14 të ligjit.

Ky udhëzim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

SHTOJCA I

MODELE TË DYSHIMTA TË PËRDORURA SI STANDARDE NDËRKOMBETARE ORIENTUESE PËR ZBULIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE DHE TË FINANCIMIT TË TERRORIZMIT

LISTA E INDIKATORËVE TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

Lista e mëposhtme jep shembuj të përgjithshëm të llojit të aktivitetit të taksapaguesit, i cili duhet kontrolluar nga inspektori i taksave gjatë inspektimit të taksapaguesit:

- Taksapaguesi drejton një organizatë bamirësie, humanitare, edukative etj., që duket e dyshimtë.
- Taksapaguesi drejton biznesin e tij/saj (p.sh. zyrë shkëmbimi valutor) pa pasur një numër identifikimi të taksapaguesit (NIPT).
- Taksapaguesi heziton ose kundërshton që të japë informacion lidhur me aktivitetin e biznesit të tij, ose jep dokumente të pazakonshme, ose të dyshimta për të identifikuar biznesin e tij/saj.
- Qëllimi i transaksionit të taksapaguesit është i pakuptimtë në pikëpamje të biznesit ose nuk përputhet me biznesin/strategjinë e deklaruar të tij.
- Pasuria neto e taksapaguesit nuk përputhet me fondet.
- Informacioni i dhënë nga taksapaguesi lidhur me burimin e fondeve është i rremë, çorientues ose krejtësisht i gabuar.
- Kur i kërkohet, taksapaguesi refuzon të identifikojë ose nuk arrin të tregojë burimet e ligjshme të fondeve dhe pasurive të tjera të tij/saj.
- Taksapaguesi (ose personi i njohur publikisht si bashkëpunëtor i tij) ka një histori të diskutueshme ose ka qenë objekt i medias për vepra të mundshme penale, civile apo rregullatore.
- Përdorimi i “personave juridikë” të shumtë, me qëllimin e vetëm marrjen dhe disbursimin e fondeve.
- Përdorimi i njësive të huaja pa ndonjë qëllim të qartë biznesi në vende ose territore të identifikuar nga autoriteti përgjegjës si vende jo bashkëpunuese.
- Taksapaguesi është nga ose ka llogari në një vend ose territor të identifikuar si jo

bashkëpunues nga FATF.

- Taksapaguesi shfaqet si agjent i një personi të padeklaruar dhe refuzon ose shmanget pa pasur arsye të ligjshme biznesi që të japë informacion lidhur me personin ose njësinë që përfaqëson.

- Taksapaguesi ka vështirësi për të përshkruar natyrën e biznesit të tij ose i mungojnë njohuritë e përgjithshme të industrisë së tij.

- Taksapaguesi hap dhe mban disa regjistra kontabiliteti apo llogari, në emër të anëtarëve të familjes ose të korporatave të ndryshme, pa pasur arsye të forta biznesi.

- Taksapaguesi paraqet fatura të rreme në Drejtorinë e Taksave, në mënyrë që të marrë TVSH-në.

- Taksapaguesi, përmes personave të emëruar, përdor transaksione fasadë (transaksione të cilat nuk kanë përmbajtje ekonomike).

LISTA E MËPOSHTME JEP DISA MODELE TË AKTIVITETEVE TË DYSHIMTA QË INSPEKTORËT E TAKSAVE DUHET T’I KENË PARASYSH LIDHUR ME AKTIVITETIN E LLOGARIVE (BANKARE, TË LETRAVE ME VLERË ETJ.)

- Taksapaguesi është përpjekur që të bëjë depozita të mëdha ose të shpeshta të valutës, ka insistuar që të veprojë vetëm me para në dorë apo ka kërkuar që të që të përjashtohet nga politikat që lidhen me depozitat e parave ose ekuivalentëve të saj.

- Taksapaguesit, transaksionet e të cilëve nuk përputhen për nga madhësia, lloji ose natyra me burimin e dukshëm të pasurisë.

- Letrat me vlerë janë paraqitur për shlyerje detyrimi me para në dorë ose për blerje letrash me vlerë, pa kaluar përmes llogarisë rrjedhëse të taksapaguesit.

- Depozita jashtëzakonisht të mëdha të bëra nga një individ ose kompani, aktivitetet e biznesit të të cilëve gjenerohen në dukje normalisht nga instrumente financiare.

- Taksapaguesi i përfshirë në transaksione me para në dorë ose ekuivalenten e saj, ose instrumente të tjera monetare që duken të strukturuar për t’iu shmangur kërkesave të ligjit për raportim për shumat 20 000 000 lekë, veçanërisht në rastet kur paratë ose instrumentet monetare janë në një sasi vetëm pak nën kufirin e raportimit ose të regjistrimit.

- Llogaria e taksapaguesit tregon transaksione të shumta në valutë ose instrumente monetare, të cilat kur mbledhen arrijnë shumat të konsiderueshme.

- Taksapaguesi transferon shumat të mëdha parash në vende ose nga vende tej bregut me instruksion për pagesë me para në dorë.

- Transferta telegrafike dhe paratë e depozituara nga taksapaguesi në llogaritë e investimit, të ndjekura menjëherë nga çeket ose transferata telegrafike në llogari të tjera.

- Blerja dhe shitja e letrave me vlerë pa qëllim dallueshëm, në rrethana që duken të pazakonshme dhe të palidhura me diversifikimin e investimit ose të rrezikut.

- Transaksionet që nuk i përmbahen praktikës normale në treg (p.sh. madhësisë së tregut, shpeshtësisë, çmimeve, mbylljes së parakohshme të prodhimeve me humbje), veçanërisht kur përfshihen para në dorë ose çeket të rimbursueshme për palë të treta.

- Përdorimi i llogarisë vetëm të kryer një numër të kufizuar transaksionesh (e ndjekur zakonisht nga një transfertë e rëndësishme fondesh në një llogari tjetër).

- Disponimi i pjesshëm ose i plotë i letrave me vlerë përmes transferimit të sasive në qendra të tjera financiare dhe jo në ato të specifikuar në kontratë, ose në favor të personave të tjerë dhe jo të atyre në emër të të cilëve janë regjistruar letrat me vlerë ose të personave në emrin e përbashkët të të cilëve ato janë regjistruar vetëm në muajt e fundit të kontratës së investimit. Llogaritë e fjetura/joaktive të cilat aktivizohen papritmas me transaksione të mëdha me para në dorë. Transferimi i fondeve për në institucione të tjera financiare/bankare të ndryshme nga ato të cilat kanë filluar fluksin e parë (veçanërisht nëse ndodhen në vende të tjera. Hyrja e blerjeve dhe shitjeve korresponduese në letra me vlerë (tregtim larës) që krijon iluzionin e tregtimit, që mund të mbulojë veprime të pastrimit të parave.

- Pagesa hyrëse të bëra nga çeket të palëve të treta ose të firmosura nga disa palë.

- Taksapaguesi i përfshirë në transaksione që nuk kanë kuptim biznesi ose strategji të dukshme investimi, ose janë në mospërputhje me strategjinë e deklaruar të biznesit të taksapaguesit.

- Blerja ose shitja e letrave me vlerë, pa qëllim të kuptueshëm ose në rrethana të pazakonshme.
- Aktivitetet ose transaksionet e taksapaguesit janë tepër komplekse.
- Taksapaguesi përzien "pasuritë e biznesit" me ato personale.
- Taksapaguesi demonstroi mungesë shqetësimi për rreziqet, komisionet apo kostot e ndonjë transaksioni tjetër.
- Llogaria e taksapaguesit ka aktivitet telegrafik të pashpjeguar ose të zgjeruar në mënyrë të papritur, veçanërisht në llogari që kanë pak ose aspak aktivitet të mëparshëm.
- Llogaria e taksapaguesit tregon transaksione të shumta valutore ose me çeqe që po të mbledhen arrijnë shumë domethënëse.
- Numër i lartë individësh që bëjnë pagesa në të njëjtën llogari pa dhënë shpjegim, të mjaftueshme.
- Llogaria e taksapaguesit ka një numër të lartë transfertash telegrafike me palë të treta që nuk kanë lidhje me qëllimin e deklaruar të biznesit të taksapaguesit.
- Llogaria e taksapaguesit ka transferta telegrafike që nuk kanë qëllim të dukshëm biznesi prej ose për të një vend i identifikuar si rreziq për pastrim parash, parajsë të sekretit bankar, apo vend i lidhur me aktivitet terrorist (d.m.th vende nën sanksione, vende jobashkëpunuese, kombe simpatizante).
- Taksapaguesi ka bërë depozitim fondesh që është ndjekur menjëherë nga kërkesa që paratë të telegrafohen ose të transferohen në palë të treta, ose të një firmë tjetër, pa asnjë arsye të qartë biznesi.
- Taksapaguesi bën një depozitim fondesh me qëllim blerjen e një investimi afatgjatë të ndjekur, menjëherë pas kësaj, nga kërkesa për likuidim të pozicionit dhe transferim të të ardhurave jashtë llogarisë.
- Taksapaguesi kërkoi që transaksioni të përpunohej në mënyrë të tillë që t'i shmangej kërkesave normale për dokumentim nga ana e firmës.
- Taksapaguesi, pa arsye bindëse ose me shenja të pazakonshme, është përfshirë në transaksione që përfshijnë lloje të caktuara letrash me vlerë, si tituj ndaj mbartësit që, megjithëse janë të ligjshme, janë përdorur në skemat mashtruese dhe aktivitet pastrimi parash. (Transaksione të tilla mund të kërkojnë procedura verifikimi për të vërtetuar ligjshmërinë e aktivitetit të taksapaguesit.).
- Llogaria e taksapaguesit tregon një nivel pashpjegueshmërisht të lartë të aktivitetit të llogarisë me nivele shumë të transaksioneve të letrave me vlerë.
- Llogaria e taksapaguesit ka hyrje fondesh ose pasurish të tjera që i kalojnë kufijtë e njohur të të ardhurave ose burimeve të taksapaguesit.
- Taksapaguesi depoziton bonde të mbartësit, të ndjekura menjëherë nga kërkesa për disbursim të fondeve.
- Transaksione të kryera në favor të palëve të panjohura.
- Taksapaguesi bën pagesa duke përdorur instrumente të shumëfishta monetare, veçanërisht nëse instrumentet janë numëruar në mënyrë të njëpasnjëshme dhe vlera bie pak nën kufirin e raportimit.
- Depozita të mëdha në të holla që përdorin kasaforta të natës, duke shmangur kontaktin direkt me institucionet financiare të licencuara.
- Transferta telegrafike të mëdha hyrëse në emër të një klienti të huaj pa arsye të qartë.
- Fonde të transferuara brenda ose jashtë një llogarie brenda së njëjtës ditë ose një periudhe relativisht të shkurtër.
- Transferta telegrafike të urdhëruara në sasi të vogla, në një përpjekje të qartë për t'iu shmangur identifikimit të kërkesave për raportim.
- Transferta të qarkulluara përmes bankave të shumta vendase ose të huaja.
- Taksapaguesi merr transfertat elektronike fondesh dhe blen menjëherë letra me vlerë të përgatitura për pagesë palëve të treta, çka është në mospërputhje me ose jashtë kursit të zakonshëm të biznesit të klientit.
- Instruksione pagesash për transferta telegrafike jashtë vendit dhe instruksione për të prituri pagesa telegrafike sasish të barabarta ose afërsisht të barabarta.
- Çdo transfertë telegrafike për/nga një palë e tretë kur identiteti i përfituesit nuk është bërë i ditur.
- Taksapaguesi ndryshon instruksionet për pagesën për t'i dërguar paratë në një bankë në një

juridiksion tej bregut.

ANEKS II

Raporti i Aktivitetit te Dyshimte		Subjekti Raportues		1
PLOTESOJENI GJITHNJË TE GJITHË RAPORTIN (ndiqni udhezimet)		☐ Banke private ☐ Shoqeri e te sigurtave ☐ Ekspert kontabel		
		☐ Hipoteke ☐ Zyra e kembimit valut ☐ Tregtar te mjeteve te transportit		
		☐ Veprimtari tregtare me metale te cmuara ☐ Perfaqesues me prokure ☐ AKP		
		☐ Ndertime ☐ OJF ☐ Administrim i prones se te treteve		
		☐ Avokat, notere ☐ Filiale, dege, agjenci te subjektit te huaj ☐ Sherbimet postare		
		☐ Tatimet ☐ Fondet e investimeve ☐ Vleresimi i pasurive te paluajtshme		
		☐ Doganat ☐ Lojra fati ☐ Transport/spedicion		
		☐ Tregti sendesh me vlere/antikuaresh		
1 Kryqezoni kutine e meposhtme vetem kur beni ndreqje te ndonje raporti te meparshem				
☐ Ndreqe e raportit te meparshem (shikoni udhezimet #3 tek "Si te plotesojme raportin?")				
Pjesa I Informacion per Institucionin Financiar Raportues				
2 Emri i Institucionit Financiar			3 Numri i identifikimit te punonjesit	
4 Adresa e Institucionit Financiar				
5 Qyteti		6 Shteti	7 Kodi Zip	
8 Adresa e deges ku ka ndodhur aktiviteti ☐ dege te shumefishta (jep shpjegime me shkrim ne Pjesen V)				
9 Qyteti		10 Shteti	11 Kodi Zip	12 Nese institucioni eshte mbyllur, jepni (data, muaji, viti)
13 numri i llogarise se ndikuar		Mbyllur?		Mbyllur?
a _____		☐ Po ☐ JO		☐ Po ☐ JO
b _____		☐ Po ☐ JO		☐ Po ☐ JO
c _____				
d _____				
Pjesa II Informacion per te Dyshuarin ☐ informacion i padisponueshem				
14 Mbiemri ose Emri i njesise		15 Emri		16 Emri i babait
17 Adresa			18 NIP,....	
19 Qyteti		20 Rrethi	21 Kodi Zip	22 Vendi
23 Nr. Telefoni-residenca (perfshi kodin lokal) ()		24 Nr. Telefoni-Puna (perfshi kodin lokal)		
25 Punesimi/Iloji i aktivitetit		26 Datelindja (muaji, data, viti)		27 pranim/rrefim? a ☐ po b ☐ jo
28 Dokumente per identifikimin e rasteve te dyshimta				
a ☐ Patenta e shoferit/shteti b ☐ pasaporta c ☐ regjistrim I huaj d ☐ te tjera (shkruaj)				
Numri _____ Autoriteti qe e ka leshuar _____				
29 lidhja me subjektin raportues:				
a ☐ llogaritar d ☐ avokat g ☐ klient j ☐ nepunes				
b ☐ agjent e ☐ huamarres h ☐ drejtor k ☐ aksioner				
c ☐ cmues f ☐ sekser i ☐ I punesuar l ☐ te tjera _____				
30 A eshte marredhenia nje marredhenie e brendshme? a ☐ Po b ☐ Jo				31 data e pezullimit, mbylljes, doreheqjes data, muaji, viti
Nese Po specifikoni: c ☐ akoma I punesuar ne institucionin financiar e ☐ perfunduar				
d ☐ I pezulluar f ☐ ka dhene doreheqje				

Pjesa III	Informacion per Aktivitetin e Dyshimte	2
------------------	---	----------

32 data ose datat e aktivitetit te dyshimte 33 sasia totale e LEK te perfshire ne aktivitetin e njohur/te dyshuar

Prej _____/_____/_____ deri _____/_____/_____ LEK , , , .00

Data Muaji Viti Data Muaji Viti

- 34 karakteristika permbledhese te aktivitetit te dyshimte:
- | | | |
|--|--|--|
| a ☐ Financim i Terrorizmit/Strukturimi/Pastrim Parash | f ☐ nderhyrje kompjuterike | l ☐ mashtrimi i kartes se debetit |
| b ☐ Bakshish/falje | g ☐ mashtrim borxhi i konsumato | m ☐ pervetesim borxhi/pervetesim parash |
| c ☐ shperdorim fondesh me cek | h ☐ falsifikim ceku | n ☐ deshmi false |
| d ☐ check balonë | i ☐ falsifikim karte krediti/debiti | o ☐ shperdorim i pozicionit |
| e ☐ mashtrim i borxhit tregtar | j ☐ instrumente te tjera falso | p ☐ mashtrim me borxhet hipotekare |
| | k ☐ mashtrimi i karte kreditit | q ☐ zhdukje e mistershme |
| | | r ☐ mashtrim me transfertat telegrafike |
| | | s ☐ te tjera _____ |

(Iloji i aktivitetit)

35 sasia e humbur perpara se te zevendesohet LEK , , , .00	36 sasia e LEK zevendesues LEK , , , .00	37 a ka pasur mashtrimi ndonje ndikim material ose a ka ose ka ndikuar ai ne situaten financiare te institucionit? a ☐ Po b ☐ Jo
---	---	--

38 A eshte njoftuar kompania e bondeve te institucionit?

a ☐ Po b ☐ Jo

39 A eshte njoftuar ndonje organ ligjor me telefon ose me shkrim per kete?

- a ☐ FIU
b ☐ Policia
c ☐ Prokuroria
d ☐

40 Emri i personit te kontaktuar ne organin ligjor?	41 Numri i telefonit (perfshi kodin lokal)
---	--

()

42 emri i personit te kontaktuar ne organin ligjor?	43 Numri i telefonit (perfshi kodin lokal)
---	--

()

Pjesa IV	Kontakte per Ndhme
-----------------	---------------------------

44 Mbiemri	45 Emri	46 Emri i babait
------------	---------	------------------

47 Titulli/punesimi	48 Numri i telefonit (perfshi kodin lokal)	49 Data e pergatitjes
---------------------	--	-----------------------

() _____/_____/_____

50 Agjencia (nese nuk eshte plotesuar nga institucioni financiar

Pjesa V	shpjegime/pershkrime te informacionit te aktivitetit te dyshimte	3
Pershkrim/shpjegime per dyshime ose informacion qe lidhet me shkelje te ligjit ose me aktivitet te dyshimte Ky seksion i raportit eshte i rendesishem. Kujdesi me te cilin shkruhet ai mund te ndikojte ne te kuptuarit e sakte te sjelljes se pershkruar dhe te natyres se saj kriminale. Jepni me poshte nje pasqyre kronologjike dhe te plote te dhunimit te mundshem te ligjit, duke perfshire cfare eshte e pazakonte, e crregullt ose e dyshimte ne lidhje me transaksionin, duke perdorur listekontrollin e meposhtem. Nese eshte e nevojshme, vazhdoni pershkrimin me fjale, ne nje faqe tjeter. (Shkruani numrin e faqeve bashkengjitur ketij raporti) a. Pershkruani dokumentacionin mbeshtetes dhe ruajeni ate per 5 vjet b Shpjegoni kush perfitoi, financiarisht ose ne ndonje forme tjeter, nga transaksioni, si dhe sa perfitoi c Ruani cdo rrefim, pranim, ose shpjegim te transaksionit te bere nga I dyshuari dhe tregoni se kujt dhe kur I eshte dhene. d Ruani cdo rrefim, pranim, ose shpjegim te transaksionit te bere nga ndonje tjeter dhe tregoni se kujt dhe kur I eshte dhene. e Ruani cdo evidence te cdo perpjekjeje per te mashtruar inspektoret e shtetit ose autoritete tjera qeveritare.	f Tregoni kur ndodhi dhunimi I mundshem (p.sh. Ne zyren qendrore, dege ose tjeter) g Tregoni nese dhunimi I mundshem eshte nje incident I izoluar apo ka lidhje me transaksione te tjera h Tregoni nese ka ndonje ceshtje te lidhur me kete, nese po specifikojte i Rekomandoni investigime te metejshme qe mund te ndihmojne autoritetet e ligjit j Tregoni nese eshte hequr ndonje informacion nga ky raport, nese po, perse? k Nese jeni duke ndrequr ndonje raport te meparshem, pershkruni ndryshimet qe po beni. Per raportet e luftes kundër pastrimit të parave/ financimit të terrorizmit dhe transaksioneve të strukturuar përfshini informacionin e mëposhtëm: l Tregoni nese jane perfshire instrumente valutore dhe/ose para. Nese po, jepni sasinë dhe pershkruni instrumentin (psh, draft bankar, leter krediti urdher xhirimi lokal ose nderkombetar, stok, bonde cek udhetari, transferata telegrafike te derguara ose te marra, kesh, etj. m Tregoni cdo numer llogarije qe mund te jete I perfshire ose i ndikuar	

ANEKS III

ISTRUKSIONE PËR PËRGATITJEN E FORMULARIT TË RAPORTIMIT TË AKTIVITETIT TË DYSHIMTË (RAD)

Këto instruksione jepen për të ndihmuar institucionet financiare (IF) për të përgatitur raportin e rishikuar të aktivitetit të dyshimtë. Institucionet financiare duhet ta konsiderojnë raportin e aktivitetit të dyshimtë dhe instruksionet që lidhen me të si zëvendësues të “formularit të sinjalizimit” të përmendur në “Rregulloren për parandalimin e pastrimit të parave” të Bankës së Shqipërisë.

Instruksione të përgjithshme

Datat – Kudo ku kërkohet të plotësohet data, ajo duhet të plotësohet duke përdorur formatin “dd/mm/vv”, kur thuhet “dd” do të thotë data, kur thuhet “mm” do të thotë muaji, kur thuhet vv do të thotë viti. Zero (0) duhet të vendoset përpara çdo numri me një shifër. Nëse muaji ose data nuk janë të disponueshme ose nuk njihen, vendosni dy zero atje ku kërkohet “mm” dhe “dd”. P.sh. 00/1/2000 tregon se është një datë e panjohur në janar të 2000.

Numrat – Kudo ku kërkohet informacion për sasinë e parave, sasi të duhet të regjistrohen duke përdorur formatin “LEK 0,000,000”. (Të rrumbullakoset numri tek LEK-u më i afërt). Të gjitha sasi të duhet të raportohen në LEK ose në ekuivalenten e vet në LEK. Nuk kërkohet të shënohen vlerat në qindarka. Raportoni sasinë dhe llojin e valutës së huaj në seksionin përshkruar në pjesën V.

Pika 1 – Ndreqje e raportit të mëparshëm – Nëse jeni duke ndrequr një raport të mëparshëm, bëni një kryq në katrorin në krye të raportit (rreshti 1). Mbusheni raportin plotësisht dhe përfshini informacionin e ndrequr në kutitë e përshtatshme. Pastaj përshkruani ndryshimet e bëra në pjesën V (Shpjegime/përshkrime të informacionit të aktivitetit të dyshimtë), rreshti k.

PJESA I

INFORMACION PËR INSTITUCIONIN FINANCIAR RAPORTUES

Pika 2 – Emri i institucionit financiar – Duhet të shkruani emrin e plotë ligjor [tregtar] të institucionit financiar (FI).

Pika 3 – Numri i identifikimit të taksapaguesit (NIPT) – Shkruani numrin e plotë të identifikimit të subjektit raportues pa përdorur alfa ose ndonjë karakter tjetër zëvendësues.

Pika 4 – Adresa e institucionit financiar ose e ndonjë subjekti tjetër raportues – Shkruani adresën e rrugës të njësisë të treguar në pikën 2. Numri i kutisë postare duhet të përdoret vetëm kur nuk ka adresë të rrugës.

Pika 5 – Qyteti – Shkruani qytetin ku ndodhet subjekti raportues.

Pika 6 – Shteti – Shkruani emrin e shtetit ku ndodhet subjekti raportues.

Pika 7 – Kodi postar – Shkruani kodin postar që i korrespondon adresës së shënuar në pikat 5 dhe 6. Nëse kodi postar nuk përdoret, shënoni 00000.

Pika 8 – Adresa e degës së zyrës (ave) ku është kryer aktiviteti –Nëse vendndodhja e aktivitetit të dyshimtë është e ndryshme nga ajo që është dhënë në pikën 4, shkruani adresën e rrugës të degës ose të zyrës ku ka ndodhur aktiviteti. Numri i kutisë postare mund të përdoret vetëm kur nuk ka adresë të rrugës. Në të kundërt, lëreni pikën 8 bosh. Nëse aktiviteti i dyshimtë ka ndodhur në më shumë se një degë, kryqëzoni kutinë që tregon degë të shumëfishta dhe përfshini informacionin në pjesën V, shpjegime/përshkrime të informacionit të aktivitetit të dyshimtë.

Pika 9 – Qyteti –Shkruani qytetin ku ndodhet dega e shënuar në pikën 8.

Pika 10 – Shteti – Përdorni shkurtimin me dy shifra për shtetet.

Pika 11 – Kodi zip – Shkruani kodin zip që i korrespondon adresës së shkruar në pikën 8.

Pika 12 – Data e mbylljes – Nëse një llogari është mbyllur, shkruani datën e mbylljes duke përdorur metodën e të shkruarit të datave të përshkruar në fillim të këtyre instruksioneve [dd/mm/vvvv].

Pika 13 – Numri(at) i llogarisë së ndikuar – Shkruani numrat e çdo llogarie të ndikuar nga aktiviteti i dyshimtë. Nëse janë ndikuar më shumë sesa 4 llogari, shkruani numrat e llogarive të tjera në pjesën V të raportit. Nëse nuk është ndikuar asnjë numër llogarie lëreni bosh pikën 13. Për çdo llogari të listuar, tregoni duke bërë një kryq në kutinë përkatëse nëse ajo është akoma e hapur apo është mbyllur.

PJESA II INFORMACION PËR TË DYSHUARIN

Nëse nuk ka informacion për të dyshuarin, bëni një kryq në kutinë “nuk ka informacion për të dyshuarin”. Kjo do të alarmojë autoritetet e ligjit dhe ato rregullatore që përdorin sistemin e të dhënave RAD për të parë nëse informacioni është zhdukur me qëllim.

Pikat 14, 15, dhe 16 – Emri i individit ose i njësisë – Nëse aktiviteti i dyshimtë përfshin një individ, shkruani mbiemrin e tij/saj në pikën 14, emrin në pikën 15 dhe emrin e babait në pikën 17. Nëse një organizatë është e përfshirë në një aktivitet kriminal, shkruajeni emrin e saj në pikën 14 dhe lëreni bosh pikat 15 dhe 16. Nëse IF ka dijeni për emrin e “Bën Biznes Si”, shkruani emrin e individit ose të organizatës në pikën 15 duke e pasuar me frazën “BBS” dhe emrin e biznesit.

P.sh. John R. Smith BBN Smith Shitje Auto ose Johnson Enterprises BBN PJ’s Pizzeria. Nëse nevojitet hapësirë shtesë për të raportuar BBN, përdorni pikat 15 dhe 16. Nëse nevojitet më shumë sesa hapësira që i është caktuar pjesës II, shtoni fletë për faqen 1 për të raportuar personat e dyshuar. Nëse janë hedhur të gjithë emrat si ata të vërtetë dhe pseudonimet, shkruani emrin e plotë ligjor në pikat 14, 15 dhe 16 dhe pseudonimet në pjesën V.

Pika 17 – Adresa – Shënoni rrugën në adresën e përhershme duke përfshirë çdo numër apartamenti ose suite të personit të identifikuar në pikat 14, 15 dhe 16. Kutia postare duhet të përdoret vetëm kur nuk ka adresë rruge. Nëse individit ose organizata është nga një vend i huaj, shkruani adresën e vendit të huaj.

Pika 18 – Shkruani numrin e sigurimeve shoqërore ose numrin e identifikimit të taksapaguesit. Nëse në pikat 14-16 paraqitet një individ, shkruani Numrin e tij të Sigurimit Shoqëror (NSS) ose numrin e identifikimit të taksapaguesit (NIPT). Nëse në pikën 14 tregohet një organizatë, shkruani numrin e identifikimit të taksapaguesit (NIPT).

Pika 19, 20, 21 dhe 22 – Qyteti, Rrethi, Kodi postar, Vendi – Shkruani qytetin në të cilin jeton

personi ose ndodhet organizata e treguar në pikat 14, 15 dhe 16. Shkruani në pikën 20 rrethin, provincën ose territorin për personin e identifikuar në pikat 14-16 dhe kodin postar në pikën 21 dhe shtetin në pikën 22. Nëse adresa është e një vendi të huaj, shkruani adresën e rrugës, të qytetit, të provincës ose të shtetit, si dhe kodin postar (nëse njihet). Shkruani emrin e plotë të shtetit (kur nuk është Shqipëria) për personin të cilit i korrespondon informacioni në pikat 14-16.

Pika 23 – Numri i telefonit – Shkruani numrin e telefonit të shtëpisë, duke përfshirë kodin lokal për çdo individ të regjistruar në pikat 14-16.

Pika 24 – Numri i telefonit – Shkruani numrin e telefonit të punës, duke përfshirë kodin lokal për individin ose organizatën e shënuar në pikat 15-17.

Pika 25 – Punësimi/lloji i biznesit – Identifikoni plotësisht punësimin, profesionin ose biznesin e personit në emër të të cilit kryhet transaksioni (et). P.sh. sekretar, shitës këpucësh, zdrukthtar, avokat, shtëpiake, pronar restoranti, shitës likernash etj. Mos përdorni terma të paspecifikuar si tregtar, i vetëpunësuar, biznesmen etj.

Pika 26 – Datëlindja – Nëse një individ përcaktohet në pikat 15-17, shënoni datën e tij/saj të lindjes duke përdorur metodën e futjes së datave të përshkruar në fillim të këtij instruksioni (dd, mm, vvvv).

Pika 27 – Pranimi/rrëfimi – Nëse i dyshuari ka bërë një pranim ose rrëfim, kryqëzoni kutinë a. Nëse jo, kryqëzoni kutinë b.

Pika 28 – Formularët e identifikimit të të dyshuarit – Bëni një kryq në kutinë e duhur për formularin e identifikimit të plotësuar nga i dyshuari dhe shkruani në rreshtat e caktuar për të dhënë të dhëna specifike, të tilla si numri i patentës ose numri i pasaportës dhe autoriteti që e ka lëshuar. Për kutinë d “të tjera”, jepni një shpjegim të shkurtër në hapësirën e caktuar për këtë. Nëse kërkohet më shumë hapësirë, hidhni informacionin në pjesën V.

Pika 29 – Marrëdhëniet me institucionin financiar – Kryqëzoni çdo kuti që identifikon marrëdhënien e të dyshuarit me IF. Mund të kryqëzohet më shumë se një kuti. Nëse kryqëzohet kutia “tjetër”, bëni një shpjegim të shkurtër në hapësirën bosh shtesë. Nëse kërkohet më shumë hapësirë, hidhni informacionin në pjesën V.

Pika 30 – A është marrëdhënia një marrëdhënie e brendshme? –Nëse i dyshuari është një marrëdhënie e brendshme, kryqëzoni kutinë a, përndryshe kryqëzoni kutinë b. Nëse marrëdhënia është e brendshme, tregoni nëse i dyshuari është akoma i punësuar, i pezulluar, i pushuar apo ka dhënë dorëheqje duke kryqëzuar kutinë c, d, e ose f.

Pika 31 – Data e pezullimit, e ndërprerjes, e dorëheqjes – Shënojeni datën kur i dyshuari është pezulluar, ndërprerë nga marrëdhënia ose ka dhënë dorëheqjen duke e shkruar datën sipas metodës së përshkruar në fillim të këtij instruksioni (dd/mm/ vvvv).

PJESA III INFORMACIONI PËR AKTIVITETIN E DYSHIMTË

Pika 32 – Data ose seria e datave të aktivitetit të dyshimtë – Hidhni datën e parë të aktivitetit të dyshimtë dhe datën e fundit që lidhet me aktivitetin e dyshimtë. Nëse ka vetëm një datë, shkruajeni atë në **hapësirën nga** sipas udhëzimeve në fillim të këtij udhëzimi. Nëse individ i ka kryer aktivitet të shumëfishtë ose aktivitete të lidhura me atë të dyshimtin gjatë periudhës raportuese, subjekti raportues mund të raportojë të gjithë aktivitetin në një RAD të vetëm. Hidhni të dhënat për aktivitetin fillestar në **hapësirën nga** dhe datën e fundit në **hapësirën deri**. (Data e parë është një e dhënë e detyrueshme) (dd/mm/ vvvv)

Pika 33 –Sasia e LEK-ve të përfshirë–Hidhni sasinë e LEK-ve të përfshirë në aktivitetin e dyshimtë. Në këtë hapësirë mund të jepet një total i përgjithshëm i të gjitha transaksioneve për aktivitete të shumëfishta të dyshimta ose të lidhura me aktivitet të dyshimtë të kryera nga i njëjti individ ose organizatë gjatë së njëjtës periudhë raportimi. Ky total mund të jepet i copëzuar në pjesën V të raportit.

Pika 34 - karakterizmi përmbledhës i aktivitetit të dyshimtë- Kryqëzoni të gjitha kutitë që identifikojnë aktivitetin e dyshimtë. Mund të kryqëzohet më shumë se një kuti. Nëse kryqëzohet kutia “të tjera”, bëni një shpjegim të shkurtër në hapësirën e dhënë. Mos e përdorni këtë hapësirë për të

zëvendësuar një përshkrim të plotë të aktivitetit në pjesën V Shpjegim/përshkrim i informacionit të aktivitetit të dyshimtë (Kjo është një hapësirë e detyrueshme për t'u plotësuar).

Pika 35- Sasia e humbur përpara se të zëvendësohej- Nëse subjekti raportues ka humbur fonde ose zotërime, shkruajeni vlerën e humbjes përpara se ajo të zëvendësohej.

Pika 36-Sasia e LEK-ve që zëvendësuan humbjen- Nëse fondet ose zotërimet janë mbuluar nga subjekti raportues, shënoni vlerën e LEK-ve zëvendësues. Shifra në LEK në rast se përmban qindarka, rumbullakoseni atë deri tek LEKU më i afërt.

Pika 37-A Ka pasur aktiviteti i dyshimtë ndonjë ndikim material ose a ka ndikuar ai në besueshmërinë e subjektit raportues? Kryqëzoni kutinë a ose kutinë b, sipas rastit.

Pika 38 – A është njoftuar kompania që mban obligacionet e institucionit? – Kryqëzoni kutinë a ose b sipas rastit.

Pika 39, 40, 41, 42, 43 – Nëse shkelja e kryer kërkon vëmendje të menjëherëshme kontaktoni agjencitë e ligjit. Kryqëzoni kutitë përkatëse për të treguar se cila nga agjencitë e ligjit është njoftuar me telefon, me shkrim ose në ndonjë mënyrë tjetër. Listoni emrat e personit (ave) të kontaktuar, numrin (at) e telefonit në pikat 41-44. Kontakti me agjencitë e ligjit nuk përjashton kërkesën për të dërguar rad.

PJESA IV KONTAKTI PËR NDIHMË

Pikat 44, 45 dhe 46 – Emri i personit të kontaktit – Shkruani emrin e personit që mund të kontaktohet për të marrë informacione shtesë. Do të ishte jashtëzakonisht me vlerë nëse individi i identifikuar në këtë seksion do të kishte njohuri specifike për faktet kryesore.

Pika 47 – Titulli/punësimi- Shënoni titullin ose punësimin e personit të kontaktit.

Pika 48 – Numri i telefonit – Shkruani numrin e telefonit, duke përfshirë kodin lokal, përmes të cilit mund të kontaktohet personi.

Pika 49 – Data e përgatitjes – Shkruani datën kur është hartuar RAD në formatin e përshkruar si në fillim të udhëzuesit (dd/mm/vvvv).

Pika 50 – Agjencia – Nëse RAD nuk është përgatitur nga insitucioni financiar, shkruani emrin e agjencisë ose organizatës qeveritare që e ka bërë atë.

PJESA V SHPJEGIME/PËRSHKRIME PËR INFORMACIONIN E AKTIVITETIT TË DYSHIMTË

Siç u përcaktua në pjesën V të RAD, ky seksion i raportit është i rëndësishëm. Kujdesi me të cilin duhet shkruar ai mund të ndikojë që sjellja e përshkruar dhe natyra e mundshme kriminale e saj të kuptohen ose jo nga Drejtoria e Luftës kundër Pastrimit të Parave, oficerët e policisë në Minsitrinë e Rendit Publik. Organizata të tjera qeveritare të Republikës së Shqipërisë, investigues dhe prokurorë. Bëni një paraqitje të plotë kronologjike të atyre çka janë të pazakonshme, të parregullta ose të dyshimta lidhur me një transaksion. Përshkrimi me shkrim duhet të përfshijë materialin e treguar në pjesën V, por gjithashtu duhet të përfshijë çdo informacion që ju besoni se është i nevojshëm për të ndihmuar investiguesit që të kuptojnë transaksionin që ju po raportoni. Nëse është e nevojshme, vazhdoni përshkrimin në një kopje të kësaj faqeje të RAD. Mbani mend se çdo dokumentacion që mbështet raportin, si p.sh. tabela, fotokopje, çeqe të anuluar apo dhe çdo dokument tjetër, foto të mbikëqyrjes etj., duhet të mbahen nga institucioni financiar ose subjekti raportues. Tregoni në pjesën V se çfarë dokumentacioni që lidhet me çështjen keni ruajtur.